# DËSHMI ARKIVI

**A-472408**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Elvis Shkambi drejt burgimit të përjetshëm për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria mbyll herimet dhe i komunikon akuzën |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/26/elvis-shkambi-drejt-burgimit-te-perjetshem-per-vrasjen-e-gjyqtarit-astrit-kalaja-prokuroria-mbyll-herimet-dhe-i-komunikon-akuzen/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 18:49:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 18:37:27 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `620717045f9b644d2459548776299209912f70d5705380b9a841f1b7c74fbf98` |
| TEKSTI | `5d31cc5abab35091ec6dec44fbccac1de70d551529955d2b05d4d1b9b4b22c86` |
| PAMJA | `3c9ceda25fa01f62439cfe90f3d14d25e373dcdfa783e699e6fe5b0b6762b4d4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e1b500e1b9bf2f681a7991324064a9c4005fab47767d3b15438376db09a0bd82` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e1b500e1b9bf2f681a7991324064a9c4005fab47767d3b15438376db09a0bd82`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Elvis Shkambi drejt burgimit të përjetshëm për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria mbyll herimet dhe i komunikon akuzën

Krim & Korrupsion

Publikuar: 26/09/2026



Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për "vrasje të funksionarëve publikë për shkak të detyrës", në kuadër të hetimeve për vrasjen e gjyqtarit të Apelit, Astrit Kalaja. Bëhet fjalë për nenin 79/a të Kodit Penal, i cili flet për vrasjen e qëllimshme të funksionarëve publikë. Ai përfshin deputetë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ushtarakë dhe zyrtarë të tjerë publikë. Vrasja duhet të jetë kryer gjatë detyrës ose për shkak të saj, dhe cilësitë e viktimës duhet të jenë të dukshme ose të njohura. Dënimi për këtë vepër është burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose burgim të përjetshëm.

Prokuroria pritet të kërkojë dënim me burg përjetë për autorin e ngjarjes që tronditi opinonin oublik. Gazetarja e Top Channel, Anila Hoxha, bën me dije se mbyllja e hetimeve për ngjarjen i është komunikuar sot Shkambit, i cili ndodhet në masën e sigurisë "arrest në burg".

Ndërkohë, sipas të njëjtave burime, Gjon Shkambit, xhaxhait të Elvis Shkambit, akuza do t'i komunikohet ditën e hënë. Elvis Shkambi përballet gjithashtu me akuzën për "vrasje në rrethana cilësuese" të mbetur në tentativë, lidhur me plagosjen e dy personave, babë e bir, që ishin palë kundërshtare në procesin gjyqësor.

Në fazat e mëparshme të procedimit, ndaj tij është hetuar edhe akuza për armëmbajtje pa leje. Sa i përket Gjon Shkambit, ai ka deklaruar se nuk kishte dijeni për planet e nipit të tij dhe se nuk ka pasur dijeni se Elvisi do të ndërmerrte një veprim të tillë. Ky

## Me te lexuarat


33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me "grupin e kokainës" për "Kullën e Historisë"


Tiranës e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit


40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fik...


Porti i Durrësit drejt zhvendosjes, por Liburn Ali nuk ndalon tenderat, miliona euro për godinat


U arrestua me urdhër të SPAK, kush është "i forti" i Shkodrës! (Emri)

qëndrim është bërë i ditur edhe më herët nga mbrojtja e tij, ndërsa Prokuroria ka ngritur dyshime për rolin e tij në ngjarje.

### Si ndodhi ngjarja

Ngjarja e rëndë ndodhi më 6 tetor 2025, rreth orës 15:40, në ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë.

Gjatë një seance gjyqësore, Elvis Shkambi qëlloi me armë zjarri drejt gjyqtarit Astrit Kalaja, si dhe drejt dy personave të tjerë, babë e bir, Ragip dhe Ervis Kurtaj, të cilët ishin palë në proces. Kalaja humbi jetën, ndërsa dy personat e tjerë mbetën të plagosur.

Sipas hetimeve të bëra publike nga Prokuroria, të shtënat ndodhën pasi gjyqtari Kalaja kishte lexuar vendimin në një çështje pronësie ku palë ishin familja Shkambi dhe familja Kurtaj.

Prokuroria ka deklaruar gjithashtu se po hetonte rolin që mund të kishte pasur Gjon Shkambi në nxitjen e veprimeve ndaj palës kundërshtare.

TAG: Astrit kalaja | burg per jete | Elvis shkambi | Prokuroria

## Të ngjashme




**SPAK hap dosjen Baks-Rrjolli/ Roli i “zonjës“ së territorit Adelina Greca, vëllezërit Efthimi dhe plani që urbanizoi tokat e resorteve**



**Katër anëtarë të familjes shqiptare u shuan në Athinë! Florinda dhe bashkëshorti ishin në muaj mjalti, vëllai i saj dhe kunata po prisnin një fëmijë**



**33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”**


## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim

## Copyrights


Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.


## Kategoritë


KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.